

Program me karakter profesional “Udhërrëfyes Turistik”

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË PROFESIONALE në Udhërrëfyes Turistik
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces akreditimi
	Program me karakter profesional 2-vjeçar
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a. Pranimi i studentëve në programet me karakter profesional, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional. b. Në këtë program studimi nota mesatare nuk është kriter pranimi. c. Renditja e kandidatëve fitues kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura. d. Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania).

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit me karakter profesional **Udhërrëfyes Turistik** është të ofrojë një formim profesional në disiplinat e gjeografisë, historisë, turizmit etj, që do të shërbejnë për studentët e diplomuar qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara në studimet e ciklit të parë në këtë degë apo të tjera të ngjashme me të. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuri për fenomenet dhe dukuritë gjeografike me ndikim në zhvillimin e turizmit.
2. Të kenë njohuri për zonat e mbrojtura natyrore.
3. Të bëjnë orientimin dhe interpretimin e hartave në terren për realizimin e udhërrëfimeve turistike.
4. Të kenë njohuri për ngjarjet historike që kanë lënë gjurmë në zhvillimet e shoqërisë njerëzore.
5. Të kenë njohuri mbi sitet historike dhe vlerat e tyre për zhvillimin turistik.
6. Të kenë njohuri për traditat, kulturën dhe gastronominë për të cilat shfaq interes turisti.
7. Njohuri mbi organizimin dhe legjislacionin në fushën e turizmit.
8. Të kenë njohuri mbi TIK në fushën e turizmit.
9. Të kenë njohuri të thelluara në gjuhën angleze.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e **udhërrëfyesit**.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi formuese që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë program studimi, do të sigurojë një performancë sa më të mirë në fushën e turizmit.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të **historisë, gjeografisë, turizmit, kulturës** etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

I. LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM:

1. Gjeografi e Shqipërisë
2. Qytetërimet e lashta
3. Trashëgimi natyrore

KREDITE (18 ECTS)

II. LËNDË TË FORMIMIT KARAKTERIZUES:

1. Turizmi urban dhe rural
2. Gjeografi e turizmit
3. Etnografi e shqiptarëve
4. Marrëdhëniet publike të entiteteve të trashëgimisë kulturore
5. Gjeografi kulturore
6. Histori antike e shqiptarëve
7. Histori mesjetare e shqiptarëve
8. Histori moderne e shqiptarëve
9. Histori bashkëkohore e shqiptarëve
10. Asetet turistike në Shqipërinë Jugore
11. Shërbimet dhe standartet për njësitë turistike
12. Marketingu dhe promocioni
13. Ndihma e shpejt dhe menaxhimi i emergjencave
14. Shkrim dhe menaxhim projektesh

KREDITE (63 ECTS)

III. LËNDË INTEGRUESE:

1. Komunikimi dhe etika e udhërrëfyesit turistik
2. Menaxhim biznesi familjar

KREDITE (6 ECTS)

IV. LËNDË ME ZGJEDHJE:

1. Histori e Bizantit (Viti I)
2. Teknika të udhërrëfimit turistik (viti I)
3. Sitet arkeologjike në Shqipëri (viti I)
4. Teknologjia e informacionit dhe turizmi (viti II)
5. Elemente të hartografisë për udhërrëfyesin turistik (viti II)
6. Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik (viti II)

KREDITE (10 ECTS)

V. LËNDË TË FORMIMIT PLOTËSUES:

1. Gjuhë angleze
2. Praktikë mësimore profesionale

KREDITE (18 ECTS)

VI. DETYRIME PËRMBYLLËSE :

KREDITE (5 ECTS)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 -54 pikë
6 (gjashtë)	55 -64pikë
7 (shtatë)	65 -74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma profesionale e programit Udhërrëfyes turistik është ura lidhëse e studentit me tregun e punës në fushën e turizmit, fushë e cila vitet e fundit po merr një zhvillim gjithnjë e më të madh. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të formojë dhe ti afrooj sa më shumë studentë me tregun e punës. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë, për të qenë sa më i aftë dhe i përgatitur për mjedisin dhe shoqërinë ku do të veprojë.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistët kualifikuar të cilët mund të punojnë në fushën e turizmit / specialist udhëtimesh të kualifikuar, punonjës administrate në zonat e mbrojtura etj. Për këtë arsye synimi i programit të studimit me karakter profesional “**Udhërrëfyes Turistik**” është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen si :

1. Specialist udhëtimesh turistike në agjensitë turistike.
2. Vetëpunësim si udhërrëfyes i udhëtimeve turistike.
3. Udhërrëfyes i udhëtimeve turistike në zonat e mbrojtura natyrore si dhe në sitet historike.
4. Punonjës në administratën e zonave të mbrojtura.
5. Specialist udhëtimesh turistike në institucione dhe organizata të ndryshme publike apo private që veprojnë në fushën e turizmit.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit **Udhërrëfyes Turistik** fitojnë njohuri të përgjithshme në fushën e Historisë, Gjeografisë, në fushën e turizmit, njohuri të cilat do ti ndihmojnë këta student për të qenë sa më të përgatitur dhe të aftë për punësimin në fushën e turizmit.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I PARË				
1.	Gjeografi e Shqipërisë	6	150	I
2.	Qytetërimet e lashta	6	150	I
3.	Trashëgimi natyrore	6	150	I
4.	Turizmi urban dhe rural	6	150	I/II
5.	Gjeografi e turizmit	6	150	II
6.	Etnografi e shqiptarëve	5	125	I
7.	Marrëdhëniet publike të entiteteve të trashëgimisë kulturore	6	150	II
8.	Gjeografi kulturore	6	150	II
9.	Gjuhë angleze	8	200	I/II
Lëndë me zgjedhje				
12.	Histori e Bizantit	5	125	II
	Teknika të udhërrëfimit turistik			
	Sitet arkeologjike në Shqipëri			
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I DYTË				
1.	Histori antike e shqiptarëve	3	75	I
2.	Histori mesjetare e shqiptarëve	3	75	II
3.	Histori moderne e shqiptarëve	3	75	I
4.	Histori bashkëkohore e shqiptarëve	3	75	II
5.	Asetet turistike në Shqipërinë Jugore	5	125	I
6.	Shërbimet dhe standartet për njësitë turistike	5	125	I
7.	Marketingu dhe promocioni	5	125	I
8.	Ndihma e shpejtë dhe menaxhimi i emergjencave	4	100	I
9.	Shkrim dhe menaxhim projektesh	3	75	II
10.	Komunikimi dhe etika e udhërrëfyesit turistik	3	75	II
11.	Menaxhim biznesi familjar	3	75	II
Lëndë me zgjedhje				
12.	Teknologjia e informacionit dhe turizmi	5	125	I
	Elemente të hartografisë për udhërrëfyesin turistik			
	Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik			
13.	Praktikë mësimore profesionale	10	250	II
14.	Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome	5	125	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	
Gjithësej viti i parë + viti i dytë		120	3000	